

KOSTIS PALAMAS

**TË JESH I BUKUR DHE TË VDESËSH**

Kostis Palamas

**Të jesh i bukur dhe të vdesësh**

Novela dhe tregime

Botimi i 1-rë, prill 2016

Përgatiti: Stavri J. DAJO

Redaktore: Eljona ZANA

Façosje: Markel DAJO

Kopertina: Romina BALLAMAÇI

ISBN: 978-618-82114-1-4

© Literatus, 2016

Botime Literatus

Odysseos 6, KP 54627 Selanik

T. +302310516251, F. +302310533900

[www.literatus.gr](http://www.literatus.gr), [info@literatus.gr](mailto:info@literatus.gr)

Askush, subjekt privat apo shtetëror, nuk ka të drejtë të riprodhojë, përdorë dhe të botojë, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, tekstet e këtij botimi, pa miratimin paraprak të botuesit përveç rasteve kur tekstet shërbejnë për citim.



K O S T I S P A L A M A S

---

**TË JESH I BUKUR  
DHE TË VDESËSH**

Novela dhe tregime

Përgatiti **Stavri J. DAJO**

LITERATUS  
Selanik 2016

**PËRMBAJTJA**

---

PËRMBAJTJA 4

PARATHËNIE 5

SHËNIM I BOTUESIT 17

TË JESH I BUKUR DHE TË VDESËSH 19

NJË UDHËTAR NË NJË FSHAT 67

BESËPRERË 71

SHKOLLA DHE SHTËPIA 103

**PARATHËNIE**

---

Kostis Palamas u lind më 13 janar 1859 në Patra. Familja e tij zë fill nga Mesolongi dhe është e njohur për burra dhe intelektualë të shquar, të cilët u shërbyen me përkushtim letrave, arsimit dhe kulturës helene. Të mirënjohur janë dy stërgjyshër të tij, Panagiotis dhe Ioannis Palamas. Mjedisi intelektual, akademik dhe njerëzit e letrave që e rrethonin, ndikuan në jetën shpirtërore të Kostis, i cili filloi të shkruante letërsi, qëkurse ishte nxënës shkollë. Por Palamas pati fatkeqësinë të mbetej jetim që në moshën gjashtëvjeçare nga të dy prindërit, të cilët humbën jetën njëri pas tjetrit, brenda dyzet ditëve dhe, kësisoj, u shtrëngua të jetonte me të fisit, i rikthyer në vendlindjen e të parëve të tij, në Mesolongi, çka la gjurmë të thellë në temperamentin dhe psikikën e tij. Vitet e vegjëlisë ishin të vështira dhe poeti i përjeton me dhimbje e depresion gjatë gjithë jetës. Humbjen e nënës e ligjëron me mjerim dhe me tragjizëm, e shpreh në vargje me forcë të veçantë artistike në librin e parë poetik *Këngët e atdheut tim* (1886).

Në vitin 1875, teksa mbaroi studimet e shkollës së mesme, u shpërngul në Athinë dhe u regjistrua në Fakultetin Juridik, porse këto studime nuk i mbaroi kurrë; i braktisi për hir të letrave. Që në këtë periudhë boton krijime artistike e, më së pari, vjersha, ndërsa një vit më vonë paraqet në një konkurs letrar të kohës *Vepra të dashurisë*, një libër poetik i cili evidentohet si i ftohtë, cerebral dhe libresk, por pa u cilësuar ithtar i ndonjë shkolle apo rryme letrare të kohës<sup>1</sup>. Vëllimi i parë poetik *Këngët e atdheut tim* është shkruar në gjuhën popullore (dhimotiki)<sup>2</sup>, në një kohë kur debati politiko-

<sup>1</sup> Beaton Roderick, *Εισαγωγή στη Νεότερη Ελληνική Λογοτεχνία* [Hyrje në Letërsinë e re greke], Nefeli, Athinë 1996, fq. 120.

<sup>2</sup> Debati shkencor katharevousa (gjuha e pastër) dhimotiki (gjuha popullore) vazhdoi për një kohë të gjatë. Katharevousa, si gjuhë zyrtare e shtetit grek, u përdor në administratën publike por, pjesërisht, edhe në letërsi deri në vitin 1976. Katharevousa cilësohet historikisht si një prirje gjuhësore për kufizimin barbarizmave dhe elementëve të të folmeve të dialekteve dhe purifikimin e skajshëm të saj, mbizotërimin e elementëve të greqishtes së vjetër dhe të gjuhës së përpunuar, në kundërvënje me prirjen tjetër, atë të dhimotikisë. Dhimotiki karakterizohet nga përdorimi i natyrshëm i greqishtes së folur (popullore) bashkëkohore e cila u cilësua si gjuhë vulgare i të folmeve dialektore nga ithtarët e arkaistëve. Gjuha standarde greke (koineja letrare)

shkencor *katharevousa* apo *dhimotiki* ishte në kulmin e vet. Libri sillte motive dhe frymëzime nga jeta e popullit të thjeshtë dhe kjo të kujtonte poezinë bukolike të Georgios Drosinis, siç vinte në dukje kritika letrare e kohës. Pavarësisht nga kjo, Palamas shfaqej para lexuesit me një profil të qartë dhe të spikatur poetik, i cili premtonte të ardhme.

Por, pas botimit të librit poetik *Himn për Athinanë* (1889), që i kushtohet bashkëshortes, emri i poetit bëhet i njohur dhe vepra e tij poetike njeh sukses të bujshëm. Disa vjet më vonë, poetit të laureuar me çmime të ndryshme tanimë dhe i lënduar pa rezerva nga shtypi, i ngarkohet krijimi i tekstit të Himnit të Lojërave Olimpikë, në vitin 1896. Një vit më vonë, emërohet sekretar në universitetin e Athinës, një emërim i bërë enkas nga Ministri i Kulturës i asaj kohe për ta nderuar dhe shpërblyer për ndihmesën e tij në letërsi dhe arte, nga ku u largua në vitin 1928. Por, në atë kohë, në ag të vitit 1898, Palamas jeton një tragjedi tjetër, i vdes i biri, Alkis, katërvjeçar, një humbje që e lëndon jashtë mase dhe të cilën nuk e tejkalon kurrë. Në kujtim të

nuk është vijim i dhimotikisë, por pasurim me forma të ndryshme (fonetike, leksikore, gramatikore) i gjuhës greke të të gjitha periudhave të zhvillimit me bazë dhimotikinë.

tij shkruan vëllimin e mirënjohur me poezi elegjiake *Varri*. Suksesi artistik dhe jehona e librit ishte e papërshekruar (u konfirmua me tre ribotime brenda vitit). Libri u përkthye në shumë gjuhë evropiane.

Në vijim, Palamas boton librat e tij më të shquar poetikë, ndër të cilët veçojmë *Dodekalogun e Evgjinit* (1907) dhe *Fyellin e mbretit* (1910), dy vepra poetike me konceptime dhe superstrukturë krejt të ndryshme.

Nga viti 1926 Kostis Palamas bëhet anëtar i Akademisë së Shkencave të Greqisë, dhe në vitin 1930 zgjidhet Kryetari i saj, një rast i rrallë në letrat e përbotshme. Kjo periudhë shënon edhe fundin e veprës së tij letrare. Poeti ishte 67 vjeç.

Nga viti 1926 deri 1940 Palamas u propozua katërmëdhjetë herë si kandidat për fitimin e çmimit Nobel për letërsinë. Në këtë periudhë fitoi dhe shumë tituj e çmime nderi kudo në botë. Në vitin 1924 qeveria franceze e nderon me titullin *Legjioni i Nderit*, qeveria gjermane më 1933 me titullin *Gëte*, po kështu çmime dhe tituj nderi fitoi në Itali dhe në Spanjë.

Në këtë kuadër, ka rëndësi të përmendim një fakt pak të njohur për lexuesin e gjerë. Në fillim të viteve '30, në një demonstrim uniteti dhe solidariteti shpirtëror, një dukuri e rrallë në kronikën ballkanike,



lindi një lëvizje gjithëgadishullore për të promovuar kandidaturën e poetit grek Kostis Palamas për fitimin e çmimit Nobel. Gjergj Fishta, miku i tij personal, bashkë me shumë personalitete të tjerë të njohur të letrave në Shqipëri, kërkuan pranë akademisë suedeze kualifikimin e kandidaturës greke të Palamas. Takimi i bujshëm i dy shkrimtarëve në Athinë, më 7 tetor 1930, pati një jehonë të madhe medjatike. Më 10 tetor 1930 gazeta *Eleftheron Vima*<sup>3</sup> botonte një shkrim me elozhe për poetin kombëtar të shqiptarëve, Gjergj Fishta. Në gjimnazin klasik françeskan të Shkodrës Gjergj Fishta ishte drejtor edhe atje mësohej gjuha e lashtë greke. Ndërsa gazeta *Demokratija*, përgjigjej me një shkrim po kaq lëvdues për Kostis Palamas, në atë kohë Kryetari i Akademisë së Shkencave të Greqisë.

Fama e Palamait i ka kapërcyer kufijtë e ngushta të Greqisë dhe është përhapur në tërë botën. Pjesë më me rëndësi të veprës së tij poetike janë përkthyer frëngjisht dhe anglisht [...] Fundi-fundi nuk duhet harruar se në vëllazërimin ballkanik do të kontribojë edhe lyra, e cila

3

*Ελεύθερον Βήμα* [Eleftheron Vima], 10-10-1930.

nevojën e vëllazërimit do ta bëjë ndjenjë të popujve ballkanikë dhe të sundonjësve të tyre<sup>4</sup>.

Megjithatë, Palamas nuk e fitoi çmimin Nobel.

Është për të shënuar, gjithashtu, dhe angazhimi antifashist i Palamas; në vitin 1940, në vigjilje të luftës italo-greke, ka qenë nismëtar dhe, së toku me personalitete të tjerë të botës së letrave dhe të komunitetit shpirtëror në gjithë botën, bashkëfirmosën një peticion në të cilën kërkohej që t'u vihej fre qëllimeve sharlataneske të pushtuesve italianë që kërkonin shkatërrimin e Maratonës antike dhe ndërtimin e një Maratone të re.

Palamas vdiq më 27 shkurt 1943. Ceremonia funerale e tij do të mbetet në histori, ngaqë kortezhi i përmortshëm, në prani të forcave të armatosura gjermane, këndoi himnin kombëtar dhe protestoi kundër pushtimit.

Ani, vepra e tij letrare ishte bërë pjesë e qëndresës popullore kundër pushtimit të huaj.

### **Proza tregimtare**

Kostis Palamas është, pa dyshim, një personalitet poliedrik që dominoi për më shumë se gjysmë shekulli në skenën letrare të Greqisë së re, madje si protagonist i saj; mbetet një nga poetët më të mëdhenj të botës helenike, dijetar diakronik dhe aktual, shprehës më i spikatur i vlerave dhe i mendësisë kombëtare, dhe, si i tillë, vijues i veprës së Dionisios Solomos, poetit kombëtar të Greqisë. Pos veprës poetike dhe prozës tregimtare, mendimi i tij estetik, eseistik dhe kritik është edhe sot e gjithë ditën aktual për risitë ideore, thellësinë filozofike dhe arsyetimin bindës. Palamas është i njohur dhe si dramaturg dhe përkthyes i letërsisë. Vepra e tij letrare mbetet në preferencat e para të lexuesit grek dhe botohet e ribotohet në vepra të veçanta apo në kolana dhe libra antologjikë, duke mëtuar një vend të veçantë.

Si prozator, Palamas dallohet me novelën *Të jesh i bukur dhe të vdesësh*. Veç saj, ai ka shkruar dhe gjashtëmbëdhjetë tregime të cilat, për hir të së vërtetës, nuk janë më inferiorë se poezia. Novela u botua për herë të parë në shtypin periodik të kohës (*Estia*, 1891) ndërsa si botim më vete në vitin 1901 dhe u prit me lavde nga kritika, por dhe u lexua me endje nga lexuesi. Dhe në ditët tona novela cilësohet si një vepër klasike me vlera të aktualizuara.

Vepra gjendet në qendër të prodhimit grek sentimentalist (estheticist). Protagonist i veprës është një djalë i ri, Mitro Rumelioti, i cili refuzon të pranojë invaliditetin e tij, pra shëmtinë fizike dhe himnizon kultin e shëndetit dhe të bukurisë trupore që barazon forcën me hijeshinë, në një gërshetim niçean dhe sentimentalist. Mitroja nuk pranon mendësinë sunduese për të jetuar vetëm për hir të jetës, me çdo mënyrë dhe formë qoftë, madje edhe duke u tërhequr zvarrë.

Disa kritikë dhe studiues kanë parë te novela një konceptim të përgjithshëm simbolik. Sipas tyre, Mitro Rumelioti simbolizon Greqinë e rrënuar ndërsa mjekët, xherahët, magjistarët dhe fallxhorët politikanët sharlatanë, mashtrues e bataçinjtë që e shkatërrojnë dhe e rrënojnë përditë. Porse kjo pikëpamje është tejet arbitrare dhe zor se mund të bazohet në domethënie figurative të veprës.

Në tregimin e gjatë *Besëprerë* Palamas trajton me sarkazëm therëse korrupsionin e klasës politike, karakterin mashtrues të premtimeve parazgjedhore, naivitetin fëmijëror të votuesve, autosugjestionin ideologjik dhe politik të elektoratit para zgjedhjeve dhe zhgënjimin tërësor pas tyre. Sipas Palamas zgjedhjet janë një farsë se kasta politike nuk ka ndryshim në përmbajtje, por vetëm në formën e

ofertave dhe të aferave. Politika, si mjet i imponimit të vullnetit politik të një grupimi mbi një tjetër, është vetvetiu një formë ushtrim dhune, pra një krim. Tregimi është shkruar me gjuhë sarkastike dhe ironi, por në thelb ka një notë dramatike, sidomos figura e heroit të tregimit i cili bie pre e naivitetit të tij, por dhe karakterit kriminal që ka politika si krim i organizuar, me situata dhe karaktere interesante, i thukët në ide dhe përmbajtje ideore dhe estetike.

Konceptim të ndryshëm artistik realist ka dhe tregimi *Shkolla dhe shtëpia* ku Palamas tregon disa nga traumat e fëmijërisë së tij. Tej mendësisë naive, tregimi ka nota dramatike për metodat skolasitike të mësimdhënies dhe plagët që ky sistem u shkaktonte fëmijëve.

Proza tregimtare e Palamas-it dallohet për konceptime interesante figurative për përshkrime të gjalla, për figura të besueshme dhe jetësore, por, në mënyrë të veçantë, për lirizmin poetik dhe aftësitë e tij fjalëformuese, gjuhën e pasur dhe të punuar, cilësi që karakterizon gjithë veprën letrare të shkrimtarit të madh.

Selanik, mars 2016

**Dr. Stavri J. DAJO**

## SHËNIM I BOTUESIT

---

Kostis Palamas nuk është autor i panjohur për lexuesin shqiptar. Kohë pas kohe, në shtypin dhe periodikun e vendit kanë parë dritën e botimit poezi si dhe pjesë nga mendimi i tij estetik dhe eseistik.

Novela *Të jesh i bukur dhe të vdesësh*<sup>5</sup> u botua për herë të parë në revistën *Nëntori* 12/1987 dhe u ribotua në revistën *Pelegrin* 5/2005 të diasporës shqiptare në Greqi dhe në të dyja rastet fitoi çmim.

Botimi i pranishëm është i pasuruar me tregimet më të spikatura të autorit, ndërsa novela në fjalë është ripunuar thellësisht nga shqipëruesi i veprës.

Literatus, ndjen për detyrë të falënderojë shkrimtaren e re Eljona Zana për punën e kujdesshme dhe me dashuri që ka bërë për redaktimin e librit dhe premtën se do të vijojë kolanën e botimeve me vepra të autorëve klasikë grekë dhe të huaj përmes përkthimeve cilësorë.

---

<sup>5</sup> Titulli i origjinalit: *O thanatos tou palikariou* (Vdekja e trimit).